



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Departamenti Teknik Juridik dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
Drejtoria Teknike
(Sektori i Tatimeve dhe Taksave Direkte)

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____/2009

**Lënda : Mbi procedurën e kthimit të mallrave të shitura nëpërmjet
përdorimit të pajisjeve fiskale**

DREJTORISË TATIMORE RAJONALE

Për të mundësuar veprimet procedurale në rastet e kthimit të mallrave të shitura nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale nga klientët (për arsye të ndryshme), dokumentimi i veprimeve duhet të kalojë detyrimisht sipas kësaj procedure :

Malli/mallrat e kthyer nga klientët, shitja e të cilave është realizuar nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, bëhet nëpërmjet një proces-verbali kthimi, (sipas modelit bashkangjitur), i cili evidenton emrin e shoqërisë shitëse, NIPT-in e saj, datën e shitjes dhe të kthimit të mallit, emrin mbiemrin e klientit (personit), llojin e mallit/mallrave kodin e tyre, sasinë e kthyer, çmimin për njësi dhe vleftën për sasi si dhe orën e kthimit. Ky dokument i cili formulohet nga shitësi i mallit në prani të klientit në çastin e dorëzimit të mallit të shoqëruar me kuponin tatimor përkatës, evidenton të gjitha të dhënat e përshkruara në proces-verbal. Ky proces-verbal prodhohet nga subjekti me numur rendor progresiv në dy kopje, nga të cilat : njëra (kopja origjinale) mbahet nga subjekti dhe një tjetër i jepet klientit e shoqëruar me mandat-pagesën e vleftës së mallit të kthyer tek subjekti nëpërmjet shitjes prej tij me pajisje fiskale.

Pas kësaj procedure, klienti mund të blerë një mall tjetër, nëpërmjet përdorimit përsëri të pajisjes fiskale, apo mund të mjaftohet thjeshtë me pagesën e kthyer.

Kjo është e vetmja mënyrë që duhet të përdoret nga tatimpaguesit për rastet e mësipërme në kushtet e përdorimit të pajisjeve fiskale të cilat janë modeluar të mos kryejnë kthime mbrapsh të veprimeve të mëparshme të regjistrimit (arkëtimeve), me qëllim që të mos lejojnë abuzime në veprimet e shitjeve nëpërmjet përdorimit të tyre.

Merrni masa për të kërkuar zbatimin e kësaj procedure gjatë kontrolleve tek tatimpaguesit të cilët janë të detyruar ligjërisht të përdorin pajisjet fiskale si dhe informoni ata në lidhje me këtë çështje.

Procedurën e mësipërme Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do ta publikojë në faqen e saj të internetit menjëherë, për t'a bërë të njohur nga ana e tatimpaguesve dhe për të kërkuar zbatimin e saj në mënyrë të barabartë dhe të unifikuar për të gjithë tatimpaguesit.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
ARTUR PAPAANI